



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Nr. Prot. _____
Br. Prot. _____
Prot. No. _____
Data _____
Datum _____
Date _____

31.10.2011

Dep. D.o.P

Nr. Prot. 01-4319/11

Br. Prot. _____

Prot. No. _____


Data _____

Datum _____

Date 31.10.2011

Prishtinë


Republika e Kosovës



Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	31.10.2011
REFERENC-Ë:	AKK-DP
PËR/ZA/TO:	z. Feti Ibishi, Drejtor i Departamentit të Prokurimit dhe Projekteve të Veçanta në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale
CC:	z. Eshref Shabani, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Shërbimet e Servisimit të Automjeteve - Rishpallje Llot I"



I nderuari z. Ibishi,

Duke u bazuar në nenin 19 pika 1.6 të Ligjit Nr. 04/L-051 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik lidhur me tenderin "Shërbimet e Servisimit të Automjeteve - Rishpallje Llot I", me nr: 209-11-025-221 në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtutjeshëm MPMS), ofron këtë:

OPINION

Që ju si Autoritet Kontraktues (në tekstin e mëtutjeshëm AK) t'i ndërmerni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim në mënyre që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës në (tekstin e mëtutjeshëm LPP).

Arsyetim

Zyra e prokurimit në MPMS, në dosjen e tenderit "shërbime" të procedurës së hapur-kontratë publike kornizë me nr. të prokurimit 209-11-025-221 me titull "shërbimet e servisimit të automjeteve rishpallje llot- I", në pjesën e II të neni V.4 të pika 6 i dosjes së tenderit të kërkesat mbi mundësitë teknike

Faqe 1 nga 2

dhe/ose profesionale AK ka kërkuar, që largësia e servisit nuk pranohet më tepër se 15 km nga objekti i MPMS te njëjtën kërkesë e ka përsëritur edhe te neni V.5 i dosjes ku kërkon që autoservisi duhet te jete me se largu ne rrethinën e kryeqendrës deri ne 15 km. Kërkesat e tilla te vendosura nga AK ne dosjen e tenderit janë ne kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

AK gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit te Aneks 3 specifikimet teknike të detyrueshme edhe pse ka shpall tenderin për llot1 në kuadër të kësaj dosje ka inkorporuar edhe llotot II dhe III, të cilat llote janë shpallur në një tender tjetër, nga kjo rrjedh se AK ka bere shkelje të nenit 27 (Dosja e Tenderit) të LPP-se.

AK te kërkesat mbi gjendjen ekonomike edhe financiare te lista e dokumenteve qe kërkohen në pikën 13 ka kërkuar qarkullimin bankar për dy vitet e fundit minimumi 200,000.00€ ekstraktin nga banka për shërbime të ngjashme me këtë veprim zyra e prokurimit ka shkelur nenin 68 të LPP-së.

AK tek neni VII.5 i pjese II te dosjes faqe 11/65 ka precizuar se tenderët duhet te jene te vlefshme për 60 dite kalendarike ndërsa te njëjtën kërkesë te deklarata e tenderueseve faqe 67/65 e ka paraqitur ne afat prej 90 ditëve nga dita e dorëzimit te tenderit, me këtë veprim AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së.

Me respekt